



Duke u mbështetur në shkronjën n) dhe r) të nenit 17, nenin 40. paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-040, Ligjin Për Financat Publike dhe Përgjegjësitë nr.05/L-007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048, Nenit 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03.L-049, nenit 7 dhe 8 të Rregullores për Subvencione dhe Transfere /2015, nenin 40 pikën 3) të Statutit të Komunës, me kërkesën nr .prot. 01-451-6056/24 të datës 27.02.2024 e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, si dhe me Rekomandimet e KPF-së të datës:08.03.0204, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 29.03.2024, mori këtë:

V E N D I M

Për

ndarjen e mjeteve buxhetore për mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë”

1. Miratohet kërkesa e DKRS-së për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej **25,000.00** euro (njëzetepesë mijë euro) për organizimin dhe mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë.”
2. Vendimi si në pikën 1 miratohet me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport me nr. prot. **01-451-6056/24** të datës: **08.02.2024**.
3. Mjetet ndahen nga kategoria e subvencioneve në DKRS, Programi (850), Nën programi (85018) Kodi funksional (0820) ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi obligohen drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Me këtë vendim njoftohen: MAPL ,Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, DKRS, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINË

01Nr. 06-M312 /24
Klinë, me 03.09 /24



Kryesuesi,
Fadil Gashi